

ILD kërkon shkarkimin e gjyqtarit Kuqo, liroi nga burgu para kohe ‘të fortin e Tiranës’

Nga [Exit News](#) 21 orë më parë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka rekomanduar Këshillit të Lartë Gjyqësor shkarkimin e gjyqtarit Markelian Kuqo, pasi ka liruar nga burgu, në mënyrë të dyshimtë, Gerd Gjeneralin, i njohur si një prej ‘të fortëve të Tiranës’.

Gjyqtari i Korçës Kuqo, në shkurt 2019, vendosi lirim me kusht të Gerd Gjeneralit, i dënuar me burgim të përjetshëm për vrasje në Itali në vitin 1997.

Pas vendimit për lirim e Gjeneralit, Ministria e Drejtësisë kërkoi hetimin e rastit.

Gerd Gjenerali (Gjinarari) ishte dënuar me burgim të përjetshëm në Itali në fillim të viteve 2000, për akuzën e vrasjes për hakmarrje të

Naim Zyberit dhe dy shqiptarëve të tjerë. Ai u transferua në Shqipëri në vitin 2014 për të vuajtur dënimin.

Katër vjet pasi u transferua në Shqipëri ai ka kërkuar në Gjykatën e Korçës lirim me kusht dhe pas rreth 10 seancash gjyqtari Markelian Kuqo ka pranuar kërkesën e tij. Shkak për pranimin e kërkesës së lirisë me kusht ishin sipas gjyqtarit Kuqo, deklaratat e Kuqos se ai “ka bërë përpjekje për shuarjen e pasojave të veprave penale” dhe se ka normalizuar plotësisht “marrëdhëniet me trashgimtarët e viktimave”.